



Pranuar / Dorezuar Punëdhësi/Prodator Received/Delivery		29.12.2023		viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Ri Prot Prot.No	Shtypje Printeg Appendix	Sasia Koliciteti Quantity	
SHK/MCHC	7756/2023		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1375/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1375/2023 të datës 03.11.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

Komuna e Prishtinës, kundër Drejtoreshës së DPZHR/Ministritsë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa Anr.1375/2023 e datës 03.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministritsë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (*tutje MBPZHR*), me datë 03.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokoli:6862/2023 nën shenjën A.nr.1375/2023, kundër Drejtoreshës së DPZHR/AM në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ankesë të cilën e ka plotësuar edhe përmes shkresës së datës 23.11.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se udhëheqësja e tij, gjegjësisht Drejtoresha e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural/ Autoritetit Menaxhues në kuadër të MBPZHR ka cenuar të drejtat e tij që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil,

ashtu që udhëheqësja e tij ka përdorur gjuhë jo etike ndaj të njëjtit duke ia cenuar integritetin e zyrtarit publik, ndërsa përmes parashtrësës së datës 23.11.2023 ankuesi pretendon se udhëheqësja e tij e ka kërcënuar për shqiptim të vërejtjes dhe inicimit të procedurës disiplinore ndaj të njëjtit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 14.11.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 03.11.2023 dërguar nga ankuesi në Këshill; Parashtrësë e datës 23.11.2023; Njoftimin e datës 01.11.2023; Procesverbalin e datës 01.11.2023; E-mailin e datës 12.10.2023 dërguar nga ankuesi për Sh.D me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; E-mailin e datës 15.08.2023 dërguar nga ankuesi për Sh.D me korrespondencën e bashkangjitur prej shtatë (7) faqesh; E-mailin e datës 30.06.2023 dërguar nga Sh. D për N.D etj me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Njoftimin e datës 01.07.2021; E-mailin e datës 01.07.2023 dërguar nga Sh.D për B.I etj; E-mailin e datës 19.07.2023 dërguar nga Sh.D për N.D me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 19.07.2023 dërguar nga N.D për Sh.D me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 23.08.2023 dërguar nga SIMBNJ për ankuesin; E-mailin e datës 21.07.2023 dërguar nga N.D për Sh.D me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.11.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 14.11.2023; Akt emërimit e ankuesit të datës 12.12.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankuesit; E-mailin e datës 19.06.2021 dërguar nga Sh.D për N.D; Njoftimin e datës 01.07.2021 dërguar nga Sh.D për B.I; E-mailin e datës 19.07.2023 dërguar nga Sh.D për N.D.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit duhet të hedhet poshtë si e pa lejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të emërimit të datës 12.12.2012 me shifër:3622 është i punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pozitën e punës: "Shef i Divizionit për Monitorim, Vlerësim e Raportim dhe Zhvillim Rural" në kuadër të Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural, ndërsa duke analizuar Procesverbalin e datës 01.11.2023 të takimit të mbajtur në mbledhjen e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural, në të cilën mbledhje ishin pjesëmarrës, Sh.D, B.I, A.S, A.S, ankuesi, G.M, L.D dhe N. D.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në procesverbalin e bashkëngjitur nga ky takim ka konstatuar se ka pasur një debat në mesë Drejtoreshës dhe ankuesit, lidhur me këto gjëra ankuesi ju ka drejtuar me shkresë Zv.Sekretares së Përgjithshme të MBZHR, por e njëjta sipas shkresave të lëndës nuk ka ndërmarr asnjë veprim.

Ankuesi lidhur me mos ndërmarrjen e asnjë veprimi nga ana e Zv.Sekretares së Përgjithshme në MBZHR, është ankuar me pretendimet lidhur me mos ndërmarrjen e veprimeve nga ana e Zv.Sekretrës së Përgjithshme duke kërkuar nga ana e KPMSHCK që të bëj zgjidhje në mosmarveshtjt e tij më mbikëqyrësen e drejtpërdrejt, për shkak të fyerjes nga ana e drejtoreshës.

Kolegji konstaton se meqenëse se Zv.Sekretarja nuk ka ndërmarr veprime dhe meqenëse si rrjedhojë me mos marrjen e veprimeve nuk ka konstatuar shkelje dhe nuk ka gjetur që ka cenim të marrëdhënies së punës së ankuesit, gjithashtu ankuesit nga shkresat e lëndës nuk ka gjetur se i është cenuar akt emërimi ose ndonjë e drejte që buron nga marrëdhënia e punës në kuadër të shërbimit civli, rrjedhimisht Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit duhet te hedhet poshtë si e pa lejuar duke u nisur nga fakti se nga shkresat e lëndës pos që ka pasur një debat në mesë Drejtoreshës dhe ankuesit nuk është shkaktuar ndonjë pasojë edhe në fakt nuk është në kompetencën e Kolegjit që të detyroj një çështje i tillë, ankuesi për fyerje, kërcënime etj., mund të përdor procedurat gjyqësore si organe kompetente për këtë rast.

Theksuar si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1375/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së